



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 05.12.2024

Nr: 45

Ora: 11:30

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 4, DATË 15.11.2024 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.12.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ledio	Braho	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ referuar vendimit nr. 187, datë 08.10.2024, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkeljet administrative për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 gisht 2024", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

**BAZË LIGJORE:** Nenet 19 pika 1 shkronja "dh", "f" dhe pika 2 e neneve 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 Kodit Zgjedhor i Republikës së

Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 2, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me shkresën nr. 2335 më datë 02.08.2024 nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) .

Nëpërmjet këtij denoncimi të regjistruar nga KQZ me nr. 2 ID, pretendohet si vijon:

*“Në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, KRIIK po monitoron nga afër gjithë procesin e përgatitjes së tyre, si dhe fushatën elektorale të subjekteve garuese, Në funksion të fushatës së tij elektorale, kandidati i Partisë Socialiste për kryetar bashkie, z. Vangjel Tavo si dhe përfaqësues të kësaj partie, kanë zhvilluar në datën 01.08.2024, një takim elektorale, në Borsh, në oborrin e shkollës së Mesme e Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh. Ky takim është postuar nga kandidati në faqen e tij zyrtare në Facebook, e shoqëruar me shkrimin:*

*“Një takim tejet i përzemërt në Borshin e bukur, me histori të pasur, me monumente kulturore historike dhe me banorë mikpritës e punëtorë. Ndihem i nderuar që banorët vendosin besimin e tyre te mua, e ndajnë me mua shqetësimet dhe problemet që hasin çdo ditë. Besimi i tyre më bën edhe më të përkushtuar që pas 4 gushtit të punoj për zgjidhje sa më të shpejta të çështjeve që e shqetësojnë komunitetin. Fjala ime sot është një premtim i mbajtur nesër. Është një kontratë publike në përmbushjen e të gjitha premtimeve pas 4 gushtit. Sepse të dielën nuk ka thjesht ZGJEDHJE por është dita kur nis ZGJIDHJA për të gjitha shqetësimet dhe nevojat e banorëve, Vangjel Tavo #1.”*

2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ. Në mbështetje të përcaktimit të nenit 8, pika 1, shkronja “a” dhe “b”, të vendimit nr. 9 datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të hetimit administrativ vendosi t’i kërkojë KAS-it vendosjen e sanksioneve administrative ndaj anëtarëve të 8 grupeve të numërimit të votave, gjithësej 28 persona.
4. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga subjektet përkatëse nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

5. Neni 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.” Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9, në nenin 3, pika 1.3/c, qartësisht ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: “vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.07.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.
6. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator”, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:
- Zj. Haide Dhuli, Drejtorit të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh, gjobë në masën 4 000 (katër mijë) lekë, referuar nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor;**
- Z. Vangjel Tavo, kandidat për bashkinë Himarë, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, referuar nenit 172, pika 1 e Kodit Zgjedhor**
7. Në përputhje me rregulloren “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, u hodh shorti për caktimin e relatorit dhe u caktua anëtari z. Elvis Çefa relator i çështjes.
8. Në datën 05.12.2024 KAS-i zhvilloi seancën e shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit në prani të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, të ngarkuar me përfaqësimin e kërkesës dhe me pjesëmarrjen e zj. Mariola Ndina, përfaqësuese me autorizim për z. Vangjel Tavo.
9. Përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, parashitroi në shqyrtimin e kërkesës rrethanat e çështjes dhe konstatimin e shklejes së kryer.

10. Përfaqësuesi me autorizim i z. Vangjel Tavo u shpreh së kandidati Partisë Socialiste, ka organizuar një takim elektorale në oborrin e shkollës së mesme të bashkuar "Qazim Pali", Borsh. Vlerësojmë se në raport me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe në raport me parashikimet e Kodit Civil, në rastin e burimeve të sistemit shkollor prauniversitar nuk gjendemi në shkelje të këtyre burimeve. Specifikimet që ligjvënësi i ka dhënë burimit në parashikimet e nenit 92 pika 2 si dhe në harmoni me nenin 142 të Kodit Civil, sanksionohet qartë se *"burim do të quhet sendi i paluajtshëm ndërtesa e lidhur me tokën e trupëzuar me të në mënyrë të qëndrueshme"*. Gjithashtu sqarojmë se në njësinë administrative Borsh, i vetmi shesh publik është oborri i shkollës së mesme të bashkuar "Qazim Pali". Në periudhën që është zhvilluar takimi, shkolla ka qënë e mbyllur.
11. KAS-i, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve dhe përgjigjet e pyetjeve, mori në shqyrtim:
- Denoncimin nr. 2 ID të protokolluar me nr. 2335 më datë 02.08.2024 nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK).
  - Vendimin nr. 187, datë 08.10.2024 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkeljet administrative për zgjedhjet e pjeshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 gisht 2024", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
  - Prapësimet e përfaqësuesit të z. Vangjel Tavo

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Gjatë diskutimeve në dhomë këshillimi, rezultoi se dy anëtarë të KAS ishin pro pranimit të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ gjobë ndaj Zj. Haide Dhuli, Drejtorit të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Qazim Pali", Borsh dhe Z. Vangjel Tavo, kandidat për bashkinë Himarë. Ndërkohë që dy anëtarët e tjerë prezent në seancë ishin kundër pranimit të kërkesës së mësipërcituar të Komisionerit.
2. Në nenin 21 të kodit Zgjedhor sanksionohet se: *"3. Aktet administrative bazë të KAS-it janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë, përveç vendimit sipas shkronjave "a", "b" ose "c" të pikës 1, kur objekt i ankimit është kundërshtimi i tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Në këtë rast vendimi merret kur pro tij votojnë së paku katër anëtarë."*

3. Duke qenë se rasti objekt shqyrtimi nuk përfshihet në kategorinë e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” ose “c” të pikës 1 të të njëjtit nen, atëherë për pranimin e kërkesës së KSHZ nevojiten që pro saj të votojnë të paktën 3 anëtarë.
4. Në këto kushte, duke qenë se numri i nevojshëm i 3 (tre) votave nuk arrihet, atëherë kërkesa nr. 4 e KSHZ “Për vendosje sanksioni administrativ” nuk mund të pranohet.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e kërkesës nr. 4 datë 15.11.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të votave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1, të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar” mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen.

U shpall sot më datë 05.12.2024

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>Braho</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>